Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (2018)	Shpenzimet (sipas vitit 2018)	I			II			III			IV			Luhatjet ne Koston per Njesi		
					Kosto per Njesi (sipas vitit 2018)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzi met (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzi met (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzi met Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III		
1	Ekzistenca e Planit Lokal të Veprimit dhe objektivave strategjikë për fëmijët në situatë rruge	Plani lokal	1	0	0	1	0	0	1	0	0	1	0	0	0	0	0		
2	Numri i fëmijëve në situatë rruge të mbështetur;	Nr. Fëmijeve	100		0	90	90	1	90	90	1	90	90	1	1	0	0		
3	Numri i familjeve në situatë rruge të mbështetura;	Numer familjesh	40		0	30		0	30		0	30		0	0	0	0		
4	Nr i rasteve të referuara.	Nr. Rastesh	72		0	70	0	0	70	0	0	20		0	0	0	0		
5	Nr i përfituesve nga funksionimi i sistemit të referimit.	Nr. Perfituesish	85		0	72	0	0	72	0	0	20		0	0	0	0		
6	Nr i takimeve të organizuara të Grupit Teknik i Punës (GTP	Nr. Takimesh	4		0	6	0	0	6	0	0	1		0	0	0	0		
7	Nr. i aktiviteteve ndërgjegjësuere.	Nr. Aktivitete sh	9	37	4	7	50	7	7	50	7	7		0.0	-4.1	7.142 857	7.142 857		
8	Nr i pjesmarrësve në aktivitete.	Nr. Pjesemarr esish	270		0	350		0	350		0	350		0.0	0.0	0	0		
9	Numri i studentëve që zhvillojnë praktikën mësimore në Bashki.	Nr. Studentesh	11	0	0	12	0	0	12	0	0	12		0.0	0.0	0	0		

10	Karta për barazi gjinore pjese e dokumenteve strategjike që zbatohet në Bashkinë e Shkodrës. Plan veprimi "Për Barazi"; Sistem të dhënash statistikore me bazë gjinore.	Karta	1	200	200	1	200	200	1	200	200	1	172	172	-28	-28	-28
11	Nr. i takimeve periodike të tryezës konsultative.	Nr. takimesh	13		0	4		0	4		0	3		0	0	0	0
12	Nr I organizatave pjesmarrese.	Nr. Organizatash	25		0	25		0	25		0	9		0	0	0	0
13	Nr. i aktiviteteve ndërgjegjësuese;	Nr. aktiviteteve	93	316	3	90	350	4	90	367	4	15	227	15	12	11	11
14	Nr. i fëmijëve dhe familjeve përfitues të shërbimeve ekzistuese dhe atyre alternative;	Nr. Perfituesve	1,650		0	1,840		0	1,840		0	250		0	0	0	0
15	Nr. partneriteteve me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese,	Nr. Partneriteteve	10		0	10		0	10		0	5		0	0	0	0
16	Nr. I modeleve të biznesit social të identifikuar në territorin e Bashkisë Shkodër.	Nr. Modele biznesi			#DIV V/0!	2		0			#DIV /0!			#DI V/0!	#DI V/0!	#DIV/ 0!	#DIV/ 0!
17	Nr. I personave që do të marrin shërbime pranë Qendrës Komunitare për Rom dhe Egjiptian	Nr. personash			#DI V/0!			#DI V/0!			#DIV /0!			#DI V/0!	#DI V/0!	#DIV/ 0!	#DIV/ 0!
18	Nr. i jetimëve të mbështetur me rastin e festave të fundit të vitit;	Nr. I perfituesve	50	400	8	50	400	8	50	400	8			#DI V/0!	#DI V/0!	#DIV/ 0!	#DIV/ 0!
19	Nr. I femijeve dhe familjeve qe marrin sherbim ne qendren e specializuar per diagnostimin e hershem e femijëve me autizem.	Nr. I perfituesve			#DI V/0!			#DI V/0!			#DIV /0!			#DI V/0!	#DI V/0!	#DIV/ 0!	#DIV/ 0!
20	Plani I Zhvillimit lokal per komunitetin rom dhe egjiptian i miratuar dhe pjese e dokumenteve strategjike te Bashkise se Shkodres	Plani I miratuar			#DI V/0!	1		0	1		0	1		0	#DI V/0!	0	0
21	Nr. i Qëndrave sociale komunitare funksionale;	Nr. I qendrave	10		0	12	10,889	907	12	10882	907	12	2680	223	223	-684	-684
22	Numri I perfituesve te sherbimeve ne qendrat.	Nr. I perfituesve	6,456		0	6,500		0	6,500		0	3,900		0	0	0	0

23	Nr. i Sherbimeve Alternative te ofruara.	Nr. sherbimes h	5	80	16	5	100	20	5	100	20	5		0	-16	-20	-20
24	Numri I femijeve dhe familjeve perfituese.	Nr. familjeve	10		0	50		0	50		0	50		0	0	0	0
25	Nr. i jetimeve perfitues te sherbimeve qe ofrohen.	Nr. Jetimeve	125		0	125		0	125		0	125		0	0	0	0
26	Numri i personelit te trajnuar te institucioneve perfitues.	Nr. Personelit	130		0	130		0	130		0	130		0	0	0	0
27	Nr. i te rinjve perfitues ne sherbimet e Qendres Rinore.	Nr. I te rinjve	720		0	300		0	300		0	120		0	0	0	0
28	Nr. i sherbimeve te ofruara ne qender per te rinjte.	Nr. I sherbimeve	6		0	6		0	6		0	6		0	0	0	0
29	Nr. i shtepive familje funksionale dhe ne sherbim te PAN. Sherbimet e ofruara per PAN-te ne shtepi-familje;	Nr I shtepive	7	17,373	2482	7	19,564	2795	7	19,564	2795	7	4,475	639	(1,843)	(2,156)	(2,156)
30	Nr. i rasteve te parandaluara drejt institucionalizimit te personave me AN.;	Nr. rastesh	5		0	8		0	8		0			#DI V/0!	#DI V/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
31	Nr. i klienteve te mbeshtetur me sherbime;	Nr. Klientesh	60		0	62		0	62		0	62		0	0	0	0
32	Numri i personave te asistuar me pagese paaftesie dhe invaliditeti;	Nr. Personash	7,515	772,556	101	8142	800,000	98	7800	395,715	98	7532	259,096	67	-34	-31	-31
33	Numri i familjeve me kryefamiljarë gra/burra te asistuar me ndihme ekonomike	Nr. Familjesh	1,835	113,265	49	3640	210,000	49	3600	75,693	49	2152	33,246	42	-7	-7	-7
34	Nr. cerdheve	Nr. Çerdheve	4	9389	2,347	4	9025	2,256	4	9057	2,264	4	544	136	-2,211	-2,120	-2,128
35	Nr foshnjeve qe frekuentojne cerdhet	Nr. Fëmijëve	155		0	155		0	155		0	155		0	0	0	0
36	Nr. i fëmijëve (vajza/djem që frekuentojnë çerdhet	Nr. I femijeve vajza	90	0	0	75		0	70		0	70		0	0	0	0

37	Numri i stafit për fëmijë	Nr. Stafit	63	26173	415	63	28086	446	63	28054	445	63	9254	147	-269	-299	-298
----	---------------------------	------------	----	-------	-----	----	-------	-----	----	-------	-----	----	------	-----	------	------	------

Për vitin 2019 në Programin “**Kujdesi social për familjet dhe fëmijët**”, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara , janë parashikuar këto aktivitete.

- **P10430.O1.A1** Zbatimi i Planit lokal të Veprimit për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë ruge.

Shtrirja e shërbimeve në territorin e Bashkisë së Shkodrës për identifikimin, mbrojtjen, trajtimin dhe fuqizimin e fëmijëve dhe familjeve në situatë ruge. Skuadra të terrenit, të përbëra nga punonjës të qendrave komunitare “Për Familjen” dhe policë Bashkiakë, funksionale në zonat kryesore ku janë identifikuar fëmijë në situatë ruge; në zonën urbane të Bashkisë së Shkodrës. Nr. i fëmijëve të identifikuar në situatë ruge si të dhe mbështetur është 120 dhe numri i familjeve në situatë ruge të mbështetura është 64.

Edhe këtë vit, në kuadër të ditës ndërkombëtare për fëmijët në situatë ruge gjatë gjithë javës 8-12 Prill në bashkëpunim me DAR dhe organizatat partnere janë realizuar një sërë aktivitete ndërgjegjësues me slogan “Mos dhuro para, dhuro kujdes”. Java e aktiviteteve u shtrinë në disa nga Qendrat komunitare “Për familjen“, të cilat kanë në fokus të punës së tyre fuqizimin dhe integrimin e komunitetit romë dhe egjiptjanë si dhe u përmyll me një aktivitet ndërgjegjësues gjithëpërfshirës, që u zhvillua në sheshin para Bashkisë. Këto aktivitete kishin si qëllim promovimin e shërbimeve dhe modeleve pozitive të integritit të fëmijëve romë dhe egjiptjan në sistemin arsimor dhe në aktivitete të tjera social kulturore që zhvillohen në qendrat tona komunitare dhe kryesisht në Qendrën Komunitare Multifunkionale “Për familjen”.

- **P10430.O2.A1.** Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje.

Për riorganizimin dhe funksionimin e sistemit të referimit për viktimat e dhunës në familje është hartuar marrëveshja e bashkëpunimit, dhe janë planifikuar aktivitete në zbatim të kësaj marrëveshje. Gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2019 janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar 4 aktivitete ndërgjegjësuese në qendrat komunitare “Për Familjen” , në kuadër të 8 marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, kundër dhunës me bazë gjinore, sipas kalendarit të paracaktuar, në bashkëpunim me organizatat. Nën moton “Me Ty” është organizuar edhe një marshim sensibilizues në mbështetje të luftës kundër dhunës ndaj të drejtave të njeriut dhe veçanërisht ndaj të drejtave të gruas, në të cilin institucionet, shoqëria civile dhe qytetarët marshuan për të drejtat dhe ngritjen e zërit ndaj dhunës që po ushtrohet ndaj vajzave dhe grave.

- **P10430.O2.A2.** Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj

Gjatë javës së Familjes janë organizuar me moton: “Së bashku Për Familjen” 13 aktivitete sensibilizuese me qëllim promovimin e vlerave të familjes dhe shërbimeve që ofrohen në fuqizim të familjes biologjike, promovimit të shërbimeve alternative me qëllim deinstitutionalizimin dhe parandalimin e institucionalizimit. Puna jonë e përditshme për fuqizimin e familjes si bërthama e shoqërisë është shoqëruar me një javë fushate sensibilizimi që synon të promovojë vlerat e Familjes dhe rëndësinë e saj si qeliza bazë e shoqërisë.

Aktivitetet janë zhvilluar në qendrat komunitare “Për Familjen” nr 3, 4, 5, Dajç, Rrethina, qendrën komunitare Multifunkionale, qendrën rinore “Atelie” dhe pedonale “Kolë Idromeno”. Nr. i pjesëmarrësve në këto aktivitete ka qenë 350.

- **P10430.O2.A3.** Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë

12 studentë; 11 të nivelit bachelor dhe 1 i nivelit master po zhvillojnë praktikën profesionale pranë shërbimit social dhe kanë kontribuar në aktivitetet e planifikuara pranë qendrave komunitare “Për Familjen”.

- **P10430.O2.A4.** Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore.

Është përmbyllur puna për hartimin dhe përgatitjen e planit të veprimit gjinor si aktiviteti i parë në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017. Dokumenti përfundimtar është prezantuar dhe miratuar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, me datë 20.12.2018. Gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2019 në zbatim të kartës dhe planit të veprimit gjinor janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar 4 aktivitete ndërgjegjësuëse në qendrat komunitare “Për Familjen”, në kuadër të 8 marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, kundër dhunës me bazë gjinore, sipas kalendarit të paracaktuar, në bashkëpunim me organizatat. Nën moton “Me Ty” është organizuar edhe një marshim sensibilizues në mbështetje të luftës kundër dhunës ndaj të drejtave të njeriut dhe veçanërisht ndaj të drejtave të gruas, në të cilin institucionet, shoqëria civile dhe qytetarët marshuan për të drejtat dhe ngritjen e zërit ndaj dhunës që po ushtrohet ndaj vajzave dhe grave.

- **P10430.O3.A1.** Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës;

Me synim koordinimin e aktiviteteve dhe shërbimeve në territorin e Bashkisë së Shkodrës, janë planifikuar dhe organizuar tryeza konsultative me shoqërinë civile.

Gjatë periudhës janar- prill janë realizuar 3 takime konsultative me organizatat partnere. Pjesëmarrëse kanë qenë 9 organizata.

- **P10430.O3.A2.** Aktivitet ndërgjegjësuës në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.

Në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, janë parashikuar një sërë aktiviteteve ndërgjegjësuëse me fëmijët dhe për fëmijët. Gjithashtu në qendrat komunitare do të organizohen takime dhe aktivitete me rastin e kësaj dite.

- **P10430.O3.A3.** Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qeshori"

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve është parashikuar një aktivitet ndërgjegjësuës për të Drejtat e Fëmijëve.

- **P10430.O3.A4.** Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi

Në kuadër të 8 marsit, Ditës Ndërkombëtare të gruas u realizua një fushatë ndërgjegjësuëse e shtrirë përgjatë të gjithë javës nën moton “Gra të guximshme, E ardhmja vetëm në dorën tuaj”.

Gjatë të gjithë javës janë zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuëse me komunitetin, me shoqërinë civile, me institucionet rajonale. Aktivitetet janë zhvilluar në institucionet kulturore, si Muzeu Historik “Oso Kuka”, Biblioteka “Marin Barleti”, Galeria e Arteve, Teatri Migjeni, qendrat komunitare “Për Familjen” dhe qendrën rinore “Atelie”. Synimi i kësaj fushate ishte promovimi i rolit të gruas në shoqëri.

- **P10430.O3.A5.** Bashkëpunimi me Fondacionin “Shpresë për botën”, për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.

Bashkia e Shkodrës ka realizuar institucionalizimin e bashkëpunimit me organizatën “Shpresë për botën”, për mbështetjen e 3 institucioneve rezidenciale; Shtëpisë së foshnjës, Shtëpisë së fëmijës shkollor dhe Qendrës së zhvillimit.

Në zbatim të marrëveshjes së arritur është përmirësuar cilësia e jetës së fëmijëve dhe të rinjve që jetojnë në institucionet rezidenciale, është rritur pjesëmarrja e fëmijëve në aktivitete të ndryshme sociale, kulturore dhe sportive, me qëllim integrimin e tyre. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar një sërë aktiviteteve social kulturore me fëmijët si dhe janë organizuar festime për ditëlindjet për fëmijët në këto institucione. Vazhdon të ofrohet mbështetje me transport për të mundësuar takimet e fëmijët me prindërit biologjikë me qëllim mbajtjen dhe fuqizimin e lidhjeve afektive mes tyre.

- **P10430.O3.A6.** Bashkëpunimi me organizatën "Sos, Fshatrat e Fëmijëve."

Në vijim të aktiviteteve të parashikuara në Marrëveshjen me Sos Fshatrat e Fëmijëve, janë zhvilluar aktivitete edukuese, formuese dhe ndërgjegjësuere me synim fuqizimin e familjes së fëmijëve në rrezik institucionalizimi dhe fëmijëve të institucionalizuar për parandalimin dhe deinstitutionalizimin e tyre.

Organizata "Sos, Fshatrat e Fëmijëve", ka bashkëpunuar dhe ka qenë pjesë e fushatave ndërgjegjësuere të zhvilluara nga bashkia Shkodër gjatë kësaj periudhë. Ka vazhduar bashkëpunimi për mbështetjen dhe fuqizimin e familjeve dhe realizimin e ndërhyrjeve konkrete në zbatim të planeve të ndërhyrjes të hartuara në bashkëpunim me anëtare të tjere të Grupit teknik Ndërsektorial për rastet e ndjekura. Gjithashtu ka vijuar bashkëpunimi për identifikimin e familjeve kujdestare dhe mbështetjen e tyre gjatë procesit të kalimit të kujdestarisë alternative.

- **P10430.O3.A7 BEGIN** - Interreg ADRION V-B 2014-2020: 'Nxitja e mbrotjes së mjedisit për përfshirje' (Boost Environmental Guardianship for Inclusion)

BEGIN - INTERREG V-B Adriatico -Jonian 2014-2020 (Adrion) 51 429.25 euro –Investime të financuara nga Bashkimi Europian në kuadër të këtij programi. Qëllimi i përgjithshëm i projektit Begin është të mbështesë krijimin e sipërmarrjeve sociale dhe rrjeteve të aktorëve që lehtësojnë sektorin e ekonomisë sociale, duke promovuar inovacionin social, me vëmendje të veçantë ndaj ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Projekti nuk ka nisur akoma implementimin, pasi është akoma në proces hapja e llogarisë së dedikuar projektit. Deri në Janar 2019 është hapur llogaria special pranë Bankës së Shqipërisë dhe është kredituar kjo llogari në shumën e paradhënies nga donator.

Është akoma në proces hapja e llogarisë speciale të projektit pranë një banke të nivelit të dytë dhe transferimi i shumës së paradhënies nga llogaria speciale pranë Bankës së Shqipërisë në llogarinë në bankën e nivelit të dytë.

Bashkia Shkodër i ka dërguar të gjithë kërkesat e nevojshme Ministrisë së Financave për këtë qëllim dhe është në pritje të finalizimit të këtij procesi.

Me datë 12 Prill 2018 Agjencia e Zhvillimit Rajonal Nova Gorica, në rolin e partnerit Lider të Projektit BEGIN kanë dërguar kërkesën zyrtare për të formalizuar daljen e Bashkisë Shkodër nga partneriteti i projektit. Bashkia Shkodër ka pranuar kërkesën dhe vendimin e partnerëve të projektit dhe zyrtarizojmë daljen e Bashkisë Shkodër nga Projekti “Interreg ADRION VB Adriatic Jonian 645 Boost Environmental Guardianship for Inclusion”.

- **P10430.O4.A1** Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me UNDP për projektin ESERE “Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët, një shtysë për përfshirjen sociale” janë realizuar ndërhyrjet e planifikuara me qëllim fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian dhe krijimin e kushteve më të mira të jetesës për këtë komunitet.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me UNDP për projektin ESERE “Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët, një shtysë për përfshirjen sociale” ka vazhduar ofrimi i shërbimeve sociale, integruese dhe mbështetëse pranë qendrës komunitare multifunktionale, për komunitetin rom dhe egjiptian.

Qendra e re multifunktionale për komunitetin rom dhe egjiptian është vënë në funksion të plotë dhe ofron shërbime specifike për komunitetin rom dhe egjiptian. Numri i përfituesve të shërbimeve gjatë këtij 4 muaji është 161. 28 persona kanë marrë shërbim me nevoja administrative, 1 fëmijë rregjistrim civil, 18 kanë marrë shërbim mjekësorë (ilace dhe vizita), 13 janë pajisur me karta shendeti, 40 persona me vaksina në qendër dhe pajisje me kartela vaksinimi, 1 mbështetje me minibiznes, 30 fëmijë mbështetje në qendër me vakt ushqimor, klasa pashkolllore, këshillime dhe lojëra.

30 me mbështetje nga iniciativat komunitare (veshje, kepecë etj).

Aktualisht po realizohet ndërhyrja e tretë infrastrukturore, në kuadër të zbatimit të projektit ESERE; rikonstruksioni i kopshtit “Guerrile”.

- **P10430.O4.A2** Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit

Është parashikuar shpërblimi i jetimëve të dalë nga strukturat rezidenciale, me rastin e festave të fundvitit. Qëllimi i kësaj ndihme është lehtësimi i situatës së tyre ekonomike dhe krijimi i një atmosfere sa më të mirë festive. Fond i planifikuar është 400 mijë lekë .

- **P10430.O4.A3** . Shërbime mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin edukativ

Ka përfunduar faza e parë e punimeve për përshtatjen e ambjentëve fizike për ofrimin e shërbimeve. Gjithashtu janë realizuar punimet për përshtatjen e ambjentëve fizike për ofrimin e shërbimeve.

- **P10430.O4.A4.** Plani I zhvillimit lokal për komunitetin rom dhe egjiptian

Në zbatim të planit të zhvillimit janë realizuar dhe ofrohen shërbimet në mbështetje dhe fuqizim të komunitetit rom dhe egjiptian.

Njëkohësisht është punuar për hartimin e raportit të parë mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Zhvillimit të Komunitetit (PZHK) Rom dhe Egjiptian të Bashkisë së Shkodrës për periudhën 2017-2020. Raporti ofron një analizë të evidencave ekzistuese në lidhje me ndryshimet në jetët e anëtarëve të dy komuniteteve, rom dhe egjiptianë, sipas gjashtë fushave prioritare të planit të veprimit, përkatësisht: regjistrimi civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë; arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor; punësimi dhe arsimi dhe formimi profesional; kujdesi shëndetësor, strehimi dhe integrimin urban; si dhe mbrojtja sociale. Duke marrë në konsideratë që monitorimi ndihmon aktorët vendor për të bërë ndryshimet e nevojshme në PZHK, ai ndër të tjera synon të ofrojë edhe rekomandimet e nevojshme për adresimin e sfidave dhe problemeve të identifikuara.

Aktualisht 65 fëmijë rom janë të përfshirë në klasa përforsuese, ndërsa 55 të tjerë të cilët janë më të ritur se moshë shkollorë, janë të përfshirë në arsim të pjesshëm dhe asistohen në Qendrën Komunitare multifunktionale ‘Për Familjen dhe Qendrën Komunitare “Për familjen” nr 5. Gjithashtu në Qendrën Multifunktionale zhvillohen klasa përgatitore për 14 fëmijë të kopshteve për vitin shkollorë 2018 - 2019 dhe klasa prindërimi ku përfitojnë 20 prindër rom dhe këshillime psikologjike për 56 fëmijë romë dhe secili prej fëmijëve përfitues kanë dosjet përkatëse të këshillimeve. Ndërsa, klasat e analfabetizmit janë përfunduar nga 13 të rinj romë në vitin 2017, ndërsa gjatë 2018, nga 8 të rinj romë. Gjithashtu, në qendrat komunitare po planifikohet të ofrohen klasa leximi për nënat rome.

Statistika më të sakta në lidhje me zbatimin e masave të parashikuara në këtë plan në të gjashtë fushat përkatëse do të jenë pjesë e Raportit të Monitorimit që do të publikohet së shpejti.

- **P10430.O5.A1.** Ngritja dhe vendosja në funksion e Qendrave Komunitare “Për Familjen”

Gjatë kësaj periudhe, sa i përket konsolidimit të shërbimit komunitar në qendrat komunitare “Për Familjen”, janë rritur shërbimet e ofruara, aktivitetet dhe përfituesit, pranë këtyrë qendrave.

Gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2019, në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimit social në territor, është arritur inagurimi dhe vënia në funksion e qendrës komunitare “Për Familjen” në njësinë administrative Rrethina, Shtoj i Vjetër.

Duke u mbështetur në shërbimet e ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqenies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë të shtrirë në të gjithë territorin Aktualisht janë funksionale 12 Qendra Komunitare “Për Familjen” të konsoliduara dhe që ofrojnë shërbime në komunitet.

- **P10430.O5.A2.** Shërbime alternative për femijet dhe familjen.

Gjatë kësaj periudhe, janë identifikuar familje në rrezik institucionalizimi dhe po punohet për fuqizimin e tyre dhe paralelisht po punohet me fuqizimin e familjeve të mundshme që kanë fëmijë në institucione rezidenciale, me synim, deinstitutionalizimin e tyre.

Sa i përket shërbimit të kujdestarisë familjare, janë organizuar 5 takime informuese dhe ndërgjegjësuere me komunitetin, mbi shërbimin e kujdestarisë familjare, ku janë shpërndarë materialet promocionale të përgatitura posacërisht për këtë shërbim. Gjithashtu kemi 12 familje kujdestare me lidhje gjaku, nga ku janë 5 fëmijë të deinstitutionalizuar, të marrë në kujdestari nga familjarët. 1 familje kujdestare pa lidhje gjaku. Në proces janë 3 raste kujdestarie; 2 me lidhje gjaku dhe një pa lidhje gjaku.

- **P10430.O5.A3.** Ndërhyrje të integruara për përfshirjen dhe integrimin socio-ekonomik të fëmijëve dhe të rinjve pa përkujdes prindëror.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me Acli Ipsia për projektin Komuniteti i të ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodrës” po zbatohen aktivitetet si; kurse të rikuperimit shkollor, edukimit të autonomisë dhe bashkëjetesës për jetimët që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe atyre që kanë dalë nga këto institucione, pas moshës 18 vjeçare.

Gjatë vitit 2018 ka filluar dhe është në proces zhvillimi i kurseve të rikuperimit shkollor ku marrin pjesë 11 të rinj dhe fëmijë që jetojnë në shtëpinë e fëmijës shkollor 6-18 vjeç, zhvillimi i kursit të autonomisë ku përfitues janë 19 fëmijë që jetojnë në shtëpinë e fëmijës 6-18 vjeç, zhvillimi i kursit të kuzhinës ku përfitues janë 9 jetimë, zhvillimi i kursit të gjuhës së huaj (anglisht) ku përfitues janë 44 fëmijë përkatësisht 9 nga shtëpia e fëmijës shkollor 6-18 vjeç, 9 nga fshati Grudë, 15 nga Vinoteka dhe 11 të rinj jetimë që jetojnë në shtëpinë familje Ravasco. Gjithashtu po zhvillohet edhe kursi i informatikës ku përfitues janë 39 fëmijë; 11 nga Gruda, 12 nga Vinoteka, 8 nga shtëpi familja Shpresa dhe 8 nga Shkodra.

- **P10430.O6.A1** Qendra Rinore "Po të Ardhmes" (Atelie)

Gjatë 4-mujorit të parë të vitit 2019 pranë Qendrës Rinore Atelie u realizuan këto aktivitete:

Janë zhvilluar takime me gjithë senatorët e shkollave publike të Bashkisë Shkodër;

Janë zhvilluar aktivitete kinematografike duke filluar me shfaqjen e një serie filmash edukativ, dokumentarësh dhe ëorkshop për të rinjtë në video-editing;

Është bashkëpunuar në organizimin e Festivalit të Shahut “Çesk Jubani” në kuadër të programit “Jeto me sportin” të Bashkisë Shkodër;

Në kuadër të projektit “Arti kundër dhunës” implementuar nga Fondacioni Arte dhe Gruaja te gruaja në bashkëpunim me Qendrën Rinore Atelie është realizuar ëorkshop-i 3 ditor mbi “Street Art” dhe Teater Social.

Është zhvilluar bootcamp “One Day Entrepreneur” mbi sipërmarrjen me të rinjtë maturantë në bashkëpunim me Metropolitan Incubator.

Është zhvilluar aktiviteti motivues për sipërmarrjen “Histori suksesi me Rona Nushin” në bashkëpunim me Europe House;

Filloi aktiviteti sensibilizues mbi shëndetin seksual “Sexual Health Education” organizuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe e Shëndetit Publik.

Është zhvilluar takimi bashkëbisedues me znj. Merita Çoba, në kuader të aktiviteteve të 8 Marsit të Bashkisë Shkodër “Gra të guximshme”

Është zhvilluar trajnimi “Puna me të miturit e pashoqëruar dhe viktimat e mundshme të trafikimit” nga Terre des Hommes në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë, Shkodër, Korçë dhe Fier.

Është zhvilluar takimi me nxënës maturant për orjentim në studime me kolegjin e Biznesit, Universitetin Europian të Tiranës.

Është zhvilluar trajnimi mbi marketing-un në bashkëpunim me ArtisanOnline.

Është zhvilluar takimi mbi Emigrimin dhe pasojat e tij në komunitet në bashkëpunim me fondacionin Mary Ęard Loreto.

Është realizuar në kuadër të projektit ESERE, financuar nga Be në partneritet me MMSR dhe UNDP, trajnimi “Mbi shërbimet e kujdesit shoqëror: për një qasje më gjithëpërfshirëse për minoritetet Romë dhe Egjiptianë”.

Janë zhvilluar takime me organizatat e shoqërisë civile për t’u informuar mbi hapjen e thirrjeve për projekt-propozime nga Ambasada SHBA.

Janë zhvilluar takime formuese mbi aplikimin për punë ose kualifikim profesional nga Zyra e Dinmak në bashkëpunim me duapunë.com

Janë organizuar dhe zhvilluar fushatat e vullnetarizmit me studentë të universitetit Luigj Gurakuqi – 150 të rinjë.

- **P10430.O7.A1.** “Asnjë Fëmijë Jashtë”

Aktiviteti “Asnjë fëmijë jashtë”, si një aktivitet artistik e kulturor gjithëpërfshirës me pjesëmarrje aktive të fëmijëve është planifikuar të zhvillohet në qendër të qytetit të shkodrës. Synimi i këtij aktiviteti është gjithëpërfshirja e fëmijëve në fusha të ndryshme të artit duke qenë vetë ata protagonist.

- **P10430.O7.A2.** Projekti “Shpresa” për personat e braktisur dhe me aftësi ndryshe;

Funksionimi i shtëpi – familjeve dhe ofrimi shërbimeve në përputhje me standartet e shërbimeve shoqërore. Mbështetja dhe financimi i aktiviteteve të 7 shtëpi – familjeve, të administruara nga organizata “Projekti Shpresa”. Në këto qendra përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, rehabilituese dhe shëndetësore 62 individë me aftësi ndryshe.

- **P010430.O8.A1.** Pagese PAK dhe Invaliditeti .

Në zbatim të Ligjin nr. 9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar, Ligjit nr.8626 datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" të

ndryshuar; Ligjit nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit" i ndryshuar, Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 "Statusi i invalidit" të ndryshuar.

Numri i personave të trajtuar me pagesë paaftësie ka qenë: në muajin Janar 4113, në Shkurt 4166, në Mars 4209, në Prill 4207.

Numri i invalidëve të punës të trajtuar me shtesë kempit ka qenë: në muajin Janar 3364, në Shkurt 3370, në Mars 3376, në Prill 3366.

Për kryerjen e këtyre pagesave mujore fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror janë si më poshtë:

PAK : Janar-Shkurt 136 200 000 Leke, Mars-Prill 130 645 000 Leke. Nga të cilat për 4 mujorin e parë të viti 2019 janë realizuar: 259 096 340 Leke.

- **P10430.O8.A2. Ndhimja ekonomike**

Në zbatim të Ligjit nr. 9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar, Vendimit Nr.955 datë 07.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për Përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhimës Ekonomike". Përfitues të skemës së ndihmës ekonomike kanë qenë:

Në muajin janar 2117 familje, nga të cilat: 1881 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 236 nga fondi i kushtezuar i bllok ndihmes deri në 6%.

Në muajin shkurt 2079 familje, nga të cilat: 1847 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 232 nga fondi i kushtezuar i bllok ndihmes deri në 6%.

Në muajin mars 2103 familje, nga të cilat: 1870 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 233 nga fondi i kushtezuar i bllok ndihmes deri në 6%.

Në muajin Prill 2114 familje, nga të cilat: 1880 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik kombëtar dhe 234 nga fondi i kushtezuar i bllok ndihmes deri në 6%.

Për kryerjen e këtyre pagesave mujore fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror janë si më poshtë:

Ndhimja Ekonomike: Janar-Shkurt 35 400 000 Leke, Mars-Prill 19 883 000 Leke. Nga të cilat për 4 mujorin e parë të viti 2019 janë realizuar: 33 246 408 Leke

Duhet të theksojmë faktin që detyrimi i mbetur në dhjetor të vitit 2018 në shumën 889 800 lekë, është shlyer me datën 15 janar 2019 me çeljen e fondeve të reja të vitit kalendarik 2019, shumë kjo e përfshirë në totalin 33 246 408 lekë të pagesave të Nd.Ekonomike.

- **P10430.O9.A1. Administrimi dhe funksionimi i çerdheve.**

Është realizuar vlerësimi i nevojave për ndërhyrje me qëllim krijimin e kushteve sa më të favorshme për foshnjat që frekuentojnë këto çerdhe dhe gjithashtu familjet e tyre. Në bashkinë e Shkodrës, ofrojnë shërbim për foshnjat dhe familjet e tyre 4 çerdhe. Numri i foshnjeve që frekuentojnë këto çerdhe është 155.

1. **„Shpenzime për paga e sigurime“**

Fondi i planifikuar për mbulimin e shpenzimeve në paga është 24.067 .mijë lekë dhe realizimi i 4 mujorit paraqitet në vlerën 7924 mije lekë dhe fondi i planifikuar për sigurime shoqërore është 4.019.mijë lekë dhe realizimi paraqitet në vlerën 1.330.mijë lekë.

2. **„Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të tjera“**

Fondi i planifikuar për këtë zë është 8.541.mijë lekë dhe realizimi i këtij artikulli paraqitet me vlerën 543 mije leke

Në zërin **“Materiale zyre dhe të përgjithshme“** „Fondi i planifikuar është 85.mijë lekë , për blerje kancelarie është në proces urdhër prokurimi.

Në zërin „**Materiale per pastrim ngrohje dhe ndriçim**“ Fondi i planifikuar është 1000.mijë lekë për të blerë materjale pastrimi, gaz për ngrohje e gatim. Blerje materiale pastrimi është realizuar urdhër prokurimi është në proces në vazhdim. Blerje gaz është parashikuar në muajt në vazhdim.

Në zërin „Furnizime me ushqime“ Fondi i planifikuar është 4300.mijë. Është në proces likuidimi.

Në zërin Blerjeve të materialeve të tjera „si batanije,dyshek etj“ fondi i planifikuar është 150. mijë lekë

Është në proces urdhër prokurimi

-Në zërin „**Shërbime nga të tretë**“ fondi i parashikuar është 1846.mijë lekë. Kjo vlerë e përfaqson faturat e energjise elektrike që është realizuar për periudhën 4 mujore në shumën prej 378 mije lekë, faturat e konsumit të ujit në shumën prej 161 mijë lekë dhe faturat e pagesës së internetit në shumën prej 4.mijë lekë. Në zërin e blerjeve të lëndëve djegëse dru zjarri fondi i parashikuar është prej 300.mijë lekë. Eshtë në proces likuidimi.

Shërbimi për dizinfektimin e ambjenteve të Çerdheve është me vlerë prej 40.mije leke. është parashikuar të realizohet në muajt në vazhdim.

Në „Zërin „**Shpenzime Transporti**““ fondi i parashikuar përfshin vlerën prej 200.mijë lekë në të cilën përfshihen shpenzimet që janë bërë për blerje karburanti. Eshte lidhur kontrata dhe është në proces likuidimi.

Në zërin „**Mirëmbajtje e zakonshme**“ fondi i planifikuar prej 580 mijë lekë përfaqëson realizimin e „Mirëmbajtjes së ndërtesave (lyerjes me bojë) me shumën prej 500.mijë lekë si , dhe vlerën prej 50 mijë lekë që përfaqsojnë shpenzimet që do të bëhen për mirëmbajtjen e aparateve dhe paisjeve teknike dhe 30.mijë lekë. për mirëmbajtje të paisjeve të zyres. Lyerja me bojë është në proces urdhër prokurorimi,ndërsa mirëmbajtja e aparateve e paisjeve teknike dhe të zyrës është parashikuar për në muajt në vazhdim.

Në zërin shpenzime për sigurimin e ndërtesave fondi i planifikuar është 40.mijë lekë. Eshtë parashikuar të realizohet në muajt në vazhdim.

3. Në zërin „**Investime**“ fondi i planifikuar është 400.mije lekë. Tek kjo vlerë përfshihet shuma prej 200 mijë lekë që do të përdoren për të blerë: lavatrice kondicionere etj dhe vlera prej 200 mijë lekë te tjera është parashikuar për të blerë paisje për sistemin e sigurisë. Eshte parashikuar te realizohen ne muajt ne vazhdim.

Aktivitete/Projekte	Buxheti në mijë lekë	Realizimi 4-mujori i 2019 në mijë lekë
P10430.O1.A1 Zbatimi i Planit lokal të Veprimit për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.	100	90
P10430.O2.A1. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje.	300	Parashikuar në muajt në vazhdim Nëntor.
P10430.O2.A2. Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj	50	Në proces realizimi
P10430.O2.A3. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë		Në proces zbatimi
P10430.O3.A1. Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës;		Në proces zbatimi
P10430.O2.A4. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore.	200	172
P10430.O3.A2. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.	50	Parashikuar ne muajt ne vazhdim Nentor

P10430.O3.A3. Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qeshori"		Ne proces planifikimi	
P10430.O3.A4. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi	167		140
P10430.O3.A5. Bashkëpunimi me Fondacionin "Shpresë për botën", për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.		Në proces zbatimi	
P10430.O3.A6. Bashkëpunimi me organizatën "Sos, Fshatrat e Fëmijëve."		Në proces zbatimi	
P10430.O3.A7 BEGIN - Interreg ADRION V-B 2014-2020: 'Nxitja e mbrotjes se mjedisit per perfshirje' (Boost Environmental Guardianship for Inclusion)	6010		Për ndjekje
P10430.O4.A1 Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian		Në proces zbatimi	
P10430.O4.A2 Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit	400	Parashikuar ne muajt ne vazhdim Nentor	
P10430.O4.A3. Shërbime mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin edukativ		Në proces zbatimi	
P10430.O4.A4. Plani I zhvillimit lokal për komunitetin rom dhe egjiptian	100		87
P10430.O5.A1. Ngritja dhe vendosja në funksion e Qendrave Komunitare "Për Familjen"	10882		2680
P10430.O5.A2. Shërbime alternative per femijet dhe familjen.	100	Parashikuar ne muajt ne vazhdim Qershor	
P10430.O5.A3. Ndërhyrje të integruara për përfshirjen dhe integrimin socio-ekonomik të fëmijëve dhe të rinjve pa përkujdes prindëror.		Në proces zbatimi	
P10430.O6.A1 Qendra Rinore "Po të Ardhmes" (Atelie)	1827		1001
P10430.O7. A1. "Asnjë Fëmijë Jashtë"	266	Parashikuar ne muajt ne vazhdim Dhjetor	
P10430.O7.A2. Projekti "Shpresa" për personat e braktisur dhe me aftësi ndryshe;	19564		4475
P10430.O8.A1. Pagesë PAK dhe Invaliditeti .	395715		259096
P10430.O8.A2. Ndihma ekonomike	75693		33246
P10430.O9.A1. Administrimi dhe funksionimi i cerdheve.	37111		9798

Nënfunkcioni 106: Strehimi Social

Programi 10661: Strehimi social

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Qëllimi i programit të “**Strehimi social**”.

- Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për 4 – mujin e parë 2019 kanë qenë:

- O1.Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë.
- O2. Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë,përmes ofrimit të alternativave për njëstrehim të gatshëm, të arritshëm, të përballeshëm dhe të përshtatshëm

Rezultatet e programit: të “**Strehimi social**”.

Programi 072	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
Plani 2019	-	1000	600	7289	8889
Realizimi 4 - muji të 2019	-	233	-	-	233

Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program duke e krahasuar me planifikimin është 2.7 % .

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara.

- Përsa i përket projektit **P10661.O1.A2** Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara Bashkia Shkodër. Përmirësim I shërbimeve bazë (Ndertim rrjeti I ujit të pijshëm) është prokuruar dhe është në proçes realizimi.
- Sa i përket aktiviteteve të administrimit të apartamenteve sociale dhe programeve të strehimit social, është krijuar Komisioni i strehimit sipas Urdhërit nr. 585, datë 18.08.2017 dhe pranë Këshillit Bashkiak të Shkodrës është prezantuar sistemi i pikëzimit për përfitimin në programet e strehimit social. Pritet vendimi nga Këshilli Bashkiak për miratimin e sistemit të pikëzimit.

- Për projektin Shërbime integruese & zhvilluese dhe administrimi i apartamenteve sociale, të krijuar për personat e dalë nga institucionet e përkujdesit rezidencial dhe gratë kryefamiljare me probleme social-ekonomike, prane Qendrës Komunitare "Për Familjen" nr 6. Nuk është miratuar ndryshimi i destinacionit të godinës nga Këshilli i Ministrave. Po punohet për realizimin e procedurave ligjore për përzgjedhjen dhe miratimin e përfituesve duke marrë parasysh ndryshimet e fundit të ligjit të ri nr. 22/2018 “ Për strehimin Social” që ka hyrë në fuqi në Nëntor 2018.
- Sfida kryesore është që nëpërmjet zbatimit të këtij projekti, të krijohet një mjedis mbështetës që do të ndihmojë dhe mbështesë për fuqizimin ekonomik, social dhe autonominë, këto shtresa vulnerabël që do të strehohen në këto banesa sociale.
- Sfidë tjetër është aspekti menaxherial dhe bashkërendues i punës në këto banesa sociale me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator si premisë e rëndësishme për fuqizimin e personave të sistemuar aty, duke synuar një përfshirje sociale më të gjerë.
- Për Projektin Strehim social sipas programeve qeveritare të banesave sociale me qera, me kosto të ulët dhe trajtimi me bonus qeraje. Mbetet problematikë plotësimi i ligjit me aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë procedurat dhe modalitetet e zbatimit të programeve sociale të strehimit. Duke marrë parasysh stafin e ri të angazhuar në çështjet e strehimit si një funksion i ri brenda drejtorisë vlerësohet si shumë e rëndësishme ngritja e kapaciteteve dhe krijimi i mundësisë së shkëmbimit të eksperiencave ndërmjet bashkive në mënyrë që të përmirësohet performanca e administratës në zbatimin e programeve sociale të strehimit, duke iu referuar nenit 74/2,3,4 sipas të cilit ministria përgjegjëse për strehimin brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji harton dhe miraton programet e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të administratës vendore.

Realizimi i treguesve të performancës.

Kodi i Programit	10661	Emertimi i programit:	Strehimi Social					
Qellimi	Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.							
Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
<i>Objektivi Specifik 1</i>	01.Permiresimi i kushteve te banimit per shtresat në nevoje							
	1	Nr. I banorëve përfitues;	3,000	3,000	3,000	3,000	100%	
	2	Nr. I familjeve përfituese;	673	673	673	673	100%	
	3	Numri I apartamenteve sociale funksionale për jetimët dhe grate kryefamiljare pa asnjë përkrahje;	26	26	26	26	100%	
	4	Nr. I aplikimeve pranë Bashkisë për strehim social	2,006	100	100	18	18%	
	5	Nr I aplikimeve pranë qeverisë dhe donatorëve për programet sociale të strehimit në vit,	1	3	3	1	33%	
	6	Nr i banesave ne rrezik shenbje	0	20	20	25	125%	

Realizimi i produkteve :

	ne 000/leke				I			II			III			IV	Luhatjet ne Koston per Njesi		
Ko di	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike 2018	Shpenzimet (sipas vitit paraardhes)	Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit e rishikuar te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III
1	Nr. I banorëve përfitues;	Nr. Banoreve	3,000	7,933	3	3,000		0	3,000	7,933	3	3,000		0	-3	0	-3
2	Nr. I familjeve përfituese;	Nr. Familjeve	673		0	673		0	673		0	673		0	0	0	0
3	Numri I apartamenteve sociale funksionale për jetimët dhe grate kryefamiljare pa asnjë përkrahje;	Nr. Apartamentesh	26		0	26		0	26		0	26		0	0	0	0
4	Nr. I aplikimeve pranë Bashkisë për strehim social	Nr. Aplikimeve	2,006	600	0	100	600	6	100	600	6	18	600	33	33	27	27
5	Nr I aplikimeve pranë qeverisë dhe donatorëve për programet sociale të strehimit në vit,	Nr. Aplikimeve	1		0	3		0	3		0	1		0	0	0	0
6	Nr i banesave ne rrezik shenbje	Nr. Banesash			#DIV/0!	20		0	20		0	25		0	#DIV/0!	0	0

Aktivitete/Projekte	Buxheti në mijë lekë	Realizimi 4-mujori i 2019 në mijë lekë
P10661.O1.A1 Shërbime integruese & zhvilluese dhe administrimi i apartamenteve sociale, të krijuar për personat e dalë nga institucionet e përkujdesit rezidencial dhe gratë kryefamiljare me probleme social-ekonomike, pranë Qendes Komunitare "Per Familjen" nr 6.	1000	233
P6190.O1.A2. (Kodi I Ministrisë) P10661.O1.A2 Projekte per permiresimin e kushteve te banimit per komunitete te pafavorizuara Bashkia Shkoder. Permiresim I shërbimeve baze (Ndertim rrjeti I ujit te pijshem)	7289	Në proces realizimi
P10661.O2.A1 Strehim social sipas programeve sociale të strehimit.	600	Në proces zbatimi
P10661.O2.A2 Projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara	-	Në proces zbatimi